

*Dionis Bubani*



# PA DOREZA

POEZI SATIRIKE



8JH-7  
1388

DIONIS BUBANI

# PA DOREZA...

---

*poezi satirike*



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

# 1. Na falni për këto mungesa...

## PËRGJIGJE E LEHTË

Ju ha merakun shpesh  
të merrni vesh  
gjithmonë  
se ç'na mungon...

... Një tok mungesash, që i dimë mirë:  
nuk kemi taksa, errësirë  
dhe as malarje e analfabetë,  
as ngritje çmimesh...  
Jemi fort të qetë:  
nuk kemi narkotikë dhe gangsterë  
dhe kjo mungesë do të ndihet kurdoherë...

Vazhdimi i përgjigjes mjaft i lehtë:  
nuk kemi as diplomaci të fshehtë,  
na falni për këtë mungesë,  
në dëshpërimin tuaj s'marrim pjesë,  
kështu do të vazhdojmë tërë jetën  
ta themi hapur të vërtetën...

Mjerisht, nuk do t'jua bëjmë qejfin kurrë,  
t'i mbani me shëndet ata dyzet flamurë,  
s'i njohim ne hipokrizitë,  
nuk do t'i shkojmë kurrë hasmit për vizitë...

Dhe mbani mend diçka me shumë vlerë:  
për ne e zeza s'është e kuqe asnjëherë!

## RRETH «IZOLIMIT»

Lotë krokodili derdhka  
Moska edhe Uashingtoni,  
singerisht u digjet shpretka:  
— Oh, ju mos u izoloni!

«Izolim!», sepse përherë  
Shqipëria korr fitore,  
di të mbrohet kurdoherë  
nga komplotet djallëzore...

Izolim kundrejt çdo helmi  
që po bredh lirisht në botë  
e tradhtive u vë shqelmin,  
që armiqtë të derdhin lotë!

## RRITUR NDËR RREBESHE

Rritur ndër rrebeshe  
Shqipëri kreshnike,  
për disa ti ishe  
«shprehje gjeografike».

Se ç't'i shqyen hartat,  
ujqit e çakejtë,  
kur t'i ndanin fushat,  
malet dhe lumenjtë...

Maska diplomate,  
plane kuptimplote,  
lidhën dhe traktate,  
bënë dhe komplete.

Helmi i ligësisë  
sipër me ca mjaltë,  
edhe historisë  
i hidhnin pak baltë,

por për ty mendonin  
çdo ditë, çdo muaj,  
kur me vrap postonin  
ndonjë princ të huaj...

Kur sulmuan «miqtë»,  
ua tregove vendin,  
qysh me pendëzinjtë  
ti e ndez kuvendin:

S'e harron asnjeri  
shqipen si i shporri,  
banjën që u bëri  
në mes të qershorit...

Në të zezë ngjyer,  
me sëpatë liktori  
e me kryq të thyer,  
lumi prap' i mori...

Kush ty të cenoi,  
s'e pati të gjatë,  
dallga i mbuloi  
mbretër dhe xhelatë...

Ti e qetë në shqotë,  
ballin lart mes vitesh,  
hapin tënd një botë  
e shikon tek ngjitesh!

## VAJTIM NË LARGËSI

Shqipëri, ti qenke  
tokë e ashpër shumë,  
malli seç na zënka,  
shpesh na del në gjumë...

Kurrë s'na besove,  
«kemi këmbë të mbarë»;  
ti nuk na lejove  
që të hyjmë as zvarrë...

Ç'fat katran me bojë,  
larg na mban, të shkretën,  
dhe me gisht në gojë  
na le tërë jetën.

...Plumba Shqipërie...  
Ujë na bëhet gjaku,  
dhe sot sikur shtie,  
Mujo Ulqinaku!

I kujtojmë plumbat,  
«pritje» për Viktorin,  
që, për pak, e lanë  
kruspull perëndorin...

Ne nuk i harrojmë  
sulmet dhe armatën  
që nëntorin sollën  
dhe për ne... mandatën!

Gur pa lojtur s'lamë,  
patëm shumë shpresa,  
se ti kishe plagë,  
kishe mjaft mungesa...

Ah, proletariati,  
diktaturë vuri,  
ndryshe ishim gati  
të lëvonte druri...

S'futëm këmbë brenda,  
nuk na eci fati:  
Mukja dhe Saranda  
e më pas Berati...

Shpresa ende patëm,  
por ç'e do, votimet...  
Prapë u rropatëm:  
erdhën shtetëzimet.

Dëm s'ërisht na vanë  
shpresat për rrëzimin,  
humbëm krejt davanë:  
hoqe shfrytëzimin...



Për ty s'u kursyen  
tërë agjenturat,  
por ti s'na kuptove,  
na përzure burrat...

E na sjell vërdallë  
festen e fqirin,  
se e zë të gjallë  
kë të shkel kufirin...

«Ndhma» ne si lumë,  
se jemi bujarë,  
japim rubla shumë,  
jo më pak dollarë.

Por ti, kokëshkreta,  
nuk pranon huara,  
me forcat e veta  
don të shkosh përpara...

Qejfin ne të ngratëve  
s'na e bëre kurrë,  
ah, kjo pritje e gjatë  
qenka një torturë...

Ti nuk paske frikë  
e s'pyet për pakte,  
paske një logjikë  
që mbërthen me fakte.

Pritëm kot, me shpresë  
të na shkonte mbarë,  
por asnjë harresë  
dhe asnjë e çarë...

Ah, mjerisht, në mote  
fati nuk na ndriti,  
kjo kështjella jote  
qenka prej graniti!

Dhe na nxjerr avaze  
që duken furtunë,  
se ke prova taze  
që na prishin punë...

Si shkëmb Shqipërie  
qenke kokëfortë,  
djeg edhe në hije  
dhe na mbyll çdo portë...

Shkuan mbushur rreshje  
vitë mbi dyzetë,  
pa një buzëqeshje,  
mbetur si të shkretë...

Nuk na kap gjë çarku  
as me grusht e puçe,  
ne na digjet barku,  
ti qëndron e kuqe!